RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0053/24
Data 09.07.2024
PRISHTINË

BORDI I RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga dispozitat e Nenit 29 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Nenit 19 paragrafit 8 të Statutit të RTK-së, Nenit 3 të Rregullores nr. 89/23., të datës 25.09.2023, për punën e Bordit të RTK-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.07.2024, merr këtë:

V E N D I M

I. Znj. Zana Spahiu, emërohet në pozitën e Ushtrueses së Detyrës së Drejtoreshës së Përgjithshme, për një periudhë të caktuar kohore, duke filluar nga data 08.07.2024, deri në përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj.

II. Obligohet, e emëruara që të udhëheqë dhe të menaxhojë veprimtarinë e RTK-së, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e saj t'i ushtrojë në përputhje me kompetencat e parapara me Ligjin Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Statutin e RTK-së, Rregulloret dhe aktet e brendshme të RTK-së, si dhe legjislacionin në fuqi.

III. E emëruara, ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i funksionit të Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga ana e Kryetarit të Bordit.

Nga një kopje e vendimit iu dërgohet:
- *Të emëruarit;*
- *Anëtarëve të Bordit të RTK-së;*
- *Sekretariatit të Bordit; dhe*
- *Administratës dhe Burimeve Njerëzore.*

Kryetar i Bordit të RTK-së
Besnik Boletini